



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. 1686 Prot.

Shkodër, më 23.08.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendim dhe relacion.

Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim relacion dhe projekt-vendim :

“PËR MIRATIMIN E DHENIES SË PELQIMIT PËR NENSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË INVESTIMIT PËR RIKONSTRUKSIONIN E TERRENEVE SPORTIVE NË “KOMPLEKSIN ZMIJANEJ” NË BASHKËPUNIM ME FSHF”.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI

**ME VENDIM DELEGIMI
Z/KRYETAR
Alban Preka**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI**

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2026

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2026

**“PËR MIRATIMIN E DHENIES SË PELQIMIT PËR NENSHKRIMIN E
MARRËVESHJES SË INVESTIMIT PËR RIKONSTRUKSIONIN E TERRENEVE
SPORTIVE NË “KOMPLEKSIN ZMIJANEJ” NË BASHKËPUNIM ME FSHF”**

Keshilli Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e tij të datës ____/____ 2026, me propozim të kryetarit të bashkisë, në mbështetje të ligji nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar; ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e bashkisë Shkoder;

V E N D O S I:

1. Të miratoj dhenien e pëlqimit dhe autorizimin e Kryetarit të bashkisë për nënshkrimin e marrëveshjes së investimit për rikonstruksionin e terreneve sportive në “Kompleksin Zmijanej” në bashkëpunim me FSHF.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Benet BECI

Me Vendim Delegimi Zv/Kryetar

Zv/Kryetar

Drejtoria Sportit




P./

Drejtoria pergjithshme kultures dhe Sportit



Drejtoria Juridike



Drejtoria Pergjithshme Juridike, Burimeve Njerezore dhe
Sherbimeve mbeshtetese





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2026

RELACION

**“PËR MIRATIMIN E DHENIES SË PELQIMIT PËR NENSHKRIMIN E
MARRËVESHJES SË INVESTIMIT PËR RIKONSTRUKSIONIN E TERRENEVE
SPORTIVE NË “KOMPLEKSIN ZMIJANEJ” NË BASHKËPUNIM ME FSHF”**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër

Të nderuar këshilltarë!

Ky relacion hartohet në mbështetje të dispozitave ligjore ne fuqi:

- Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligjit 7850 date 29.07.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, te ndryshuar;
- Ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”;

Bashkia Shkoder në shërbim të komunitetit dhe zhvillimit të aktiviteteve sportive, si dhe në kuadër të përgatitjeve infrastrukturore dhe organizative për zhvillimin e UEFA Kampionatit European U-21 2027, Federata Shqiptare e Futbollit ka ndjekur nga afër identifikimin dhe përgatitjen e terreneve sportive që do të shërbejnë për nevojat operative të turneut, në përputhje me kërkesat organizative dhe standardet e përcaktuara për këtë aktivitet.

Në këtë kontekst, dhe pas monitorimit e verifikimit të disa terreneve sportive në territorin e Bashkisë Shkodër, ka rezultuar se kompleksi "Zmijanej" paraqitet si alternativa më e përshtatshme për realizimin e një investimi të menjëhershëm dhe funksional, duke marrë në konsideratë pozicionin e tij, kushtet aktuale infrastrukturore, potencialin për përshtatje sipas kërkesave të aktivitetit, si dhe mundësinë reale për përfundimin e punimeve brenda afateve të nevojshme.

Përzgjedhja e këtij kompleksi lidhet drejtpërdrejt me kërkesen e paraqitur nga FSHF me shkresen nr.739 dt 14.05.2026 ku ka arsyetuar nevojën që qyteti i Shkodrës të ketë në dispozicion terrene sportive të gatshme dhe funksionale, të cilat mund të mbështesin organizimin e turneut sipas parametrave të miratuara nga UEFA, veçanërisht për nevojat e skuadrave pjesëmarrëse, seancave stërvitore, operacioneve të transferimit dhe aktiviteteve të tjera mbështetëse në kuadër të UEFA U-21, EURO 2027.

Për këtë arsye, ju drejtohem me këtë projekt vendim për mbështetjen tuaj për dhenien e miratimit në parim për nënshkrimin e marrëveshjes me FSHF për rikonstruksionin e dy terreneve sportive në kompleksin "Zmijanej", ku 50% e volumnit të punimeve do të kryhen

nga Bashkia Shkoder nepermjet edhe dy strukturave te saj institucione te varesise konkretisht nga Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike si dhe nga Ndermarrja e Sherbimeve dhe Punenve Publike, me synim qe keto terrene te permbushin kushtet e nevojshme teknike dhe operacionale per t'u perdorur ne kuader te ketij eventit europian.

Njekohesisht, ne vijim te kerkeses se FSHF, Bashkia Shkoder ka kerkuar pelqimin e Kompleksit Zmijanej per investimin per keto dy terrene sportive, dhe ky i fundit ka shprehur dakortesine nepermjet emailit te dates 8 qershor 2026.

Pas perfundimit te rikonstruksionit, kompleksi "Zmijanej" do te vendose ne dispozicion te Federates Shqiptare te Futbollit keto dy terrene sportive per zhvillimin e aktiviteteve, programeve dhe angazhimeve sportive te lidhura me pergatitjet dhe realizimin e UEFA U-21 EURO 2027, si dhe per nevoja te tjera organizative te FSHF-se ne funksion te turneut.

Sa me siper, ky investim nuk perfaqeson vetem nje nevojë te menjehershme ne funksion te organizimit te kampionatit, por edhe nje mundësi konkrete per te lenë pas nje trashëgimi infrastrukturore dhe sportive per qytetin e Shkodrës, duke rritur kapacitetet pritëse dhe standardin e faciliteteve sportive ne sherbim te futbollit dhe te rinjve, *propozojme* para jush per miratim projekt vendimin;

“PËR MIRATIMIN E DHENIES SË PELQIMIT PËR NENSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË INVESTIMIT PËR RIKONSTRUKSIONIN E TERRENEVE SPORTIVE NË “KOMPLEKSIN ZMIJANEJ” NË BASHKËPUNIM ME FSHF”

Duke ju falenderuar per bashkepunimin!

KRYETAR

Benet BECI

Alban Prokaj

P/ Drejtoria pergjithshme kultures dhe Sportit

Drejtor

Drejtoria Sportit

Drejtor

Arson Mllati